

VENDIM
Nr. 810, datë 24.12.2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 18/2, të vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 18/3, me këtë përmbajtje:

“18/3. Paga mujore për punonjësit, që punojnë në pozicionin “prozektor” në Institutin e Mjekësisë Ligjore, të jetë e njëjtë me pagën mujore për të njëjtin pozicion pune në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e personelit mjekësor dhe punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.”.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga momenti i emërimit të punonjësve në pozicionet e punës “prozektor” në strukturën dhe organikën e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe përballohen nga buxheti i miratuar për këtë institucion.

3. Ngarkohet Instituti i Mjekësisë Ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama